

TESTI PROFESIONAL
E DREJTA E BE DHE E DREJTA NDËRKOMBËTARE PUBLIKE
TEZA 3

Pyetja I (8 pikë)

Si e kuptoni efektin e drejtpërdrejtë të së drejtës europiane (acquis) në të drejtën e brendshme të shteteve anëtare? Referuar jurisprudencës së GJDBE, në cilën çështje u vendos ky parim?

Përgjigje: E drejta europiane (acquis e BE-së) përbëhet nga tërësia e normave që përfshijnë burimet parësore dhe dytësore të së drejtës, siç janë: traktatet, marrëveshjet ndërkombëtare, rregulloret, direktivat, rekomandimet, etj. E drejta europiane përbën një sistem autonom të së drejtës, që ekziston krahas së drejtës së shteteve anëtare. Parimi i efektit të drejtpërdrejtë do të thotë që e drejta europiane parashikon jo vetëm detyrime për institucionet e BE-së dhe Shtetet Anëtare, por edhe të drejta për qytetarët e BE-së (individë apo persona juridikë), të cilët mund t'i mbrojnë ato përpara gjykatave kombëtare, pavarësisht të drejtës së brendshme.

Në fillimet e ekzistencës së komuniteteve europiane, teza mbizotëruese ishte se e drejta komunitare (si pjesë e së drejtës ndërkombëtare) u drejtohej vetëm shteteve anëtare dhe ajo nuk parashikonte të drejta dhe detyrime për individët apo subjektet e tjera të së drejtës. Traktatet e Komuniteteve nuk shpreheshin për natyrën apo zbatimin e së drejtës komunitare. Por, kjo tezë u ndryshua me vendimin e Gjykatës së Drejtësisë në çështjen *Van Gend en Loos v Netherlands Inland Revenue Administration* (C 26-62, Van Gend & Loos). Gjykata e zbatoi këtë parim pavarësisht kundërshtive që kishin në fillim disa Shtete Anëtare, duke garantuar kështu vetë ekzistencën e rendit juridik të BE-së. Në çështjen Van Gend & Loos firma holandeze e transportit ngriti padi përpara një gjykate holandeze kundër autoriteteve doganore që i vendosën asaj detyrime të larta doganore mbi një produkt kimik të importuar nga Republika Federale e Gjermanisë. Përfundimi i kësaj çështjeje varej nga pyetja drejtuar GJED-së, nëse individët mund të bazoheshin në nenin 12 të Traktatit KEE-së, i cili, brenda Tregut të Përbashkët, ndalonte në mënyrë të shprehur vendosjen e detyrimeve të reja, apo rritjen e detyrimeve ekzistuese nga Shtetet Anëtare. GJED në arsyetimin e vendimit të saj, u shpreh se: "...Komuniteti përbën një rend të ri juridik....subjektet e të cilit nuk janë vetëm Shtetet Anëtare, por edhe shtetasit e tyre. Pavarësisht nga legjislacioni i Shteteve Anëtare, e drejta komunitare jo vetëm që vendos detyrime ndaj individëve, por synon gjithashtu që t'u japë atyre të drejta.

GJED ka parashikuar efektin e drejtpërdrejtë të zbatueshëm në përgjithësi për të gjitha burimet kryesore të së drejtës europiane, si: Traktatet, Marrëveshjet Ndërkombëtare, Rregulloret, Direktivat dhe Vendimet. Rekomandimet dhe Opinionet duke qenë se nuk janë të detyrueshme, nuk kanë efekt të drejtpërdrejtë. Efekti i drejtpërdrejtë i dispozitave të Traktatit, por edhe i Marrëveshjeve Ndërkombëtare varet nga plotësimi i disa kushteve që kanë të bëjnë me natyrën e dispozitës, e cila duhet të: (i) jetë e saktë, (ii) e qartë dhe e pakushtëzuar (iii) dhe të mos kërkojë



masa shtesë, qoftë kombëtare apo europiane. Rregulloret janë direkt të zbatueshme, e për pasojë, kanë efekt të drejtpërdrejtë. Direktivat duhen transpozuar në të drejtën e brendshme dhe ato mund të kenë efekt të drejtpërdrejtë, atëherë kur dispozitat janë të pakushtëzuara, të qarta dhe kur shteti nuk i ka transpozuar brenda afatit të parashikuar nga vetë direktiva. Vendimet kanë efekt të drejtpërdrejtë kur u drejtohen shteteve të caktuara. Ekzistojnë dy aspekte të efektit të drejtpërdrejtë: vertikal dhe horizontal. Efekti i drejtpërdrejtë vertikal zbatohet në konfliktet ndërmjet individëve dhe shtetit. Efekti i drejtpërdrejtë horizontal zbatohet në konfliktet ndërmjet individëve.

Pyetja II (10 pikë)

Cilët janë dallimet dhe elementët e përbashkët që përmbajnë Statuti i Lidhjes së Kombeve dhe Karta e Organizatës së Kombeve të Bashkuara?

Përgjigje: Statuti i Lidhjes së Kombeve, si edhe Karta e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, janë akte themeltare të dy organizatave ndërkombëtare universale, të krijuara menjëherë pas dy luftërave botërore, respektivisht Lidhja e Kombeve (LK) dhe Organizata e Kombeve të Bashkuara. Statuti i LK u miratua në vitin 1919, ndërsa Karta e OKB u miratua në vitin 1945.

Të dy aktet, parashikojnë si objektiva kryesorë të organizatave respektive, ruajtjen e paqes dhe të sigurisë ndërkombëtare. Por ndërsa sipas Statutit të LK të dy organet, Asambleja dhe Këshilli, ushtronin kompetenca për ruajtjen e paqes dhe të sigurisë ndërkombëtare, duke u përplasur shpesh me njëri-tjetrin, sipas Kartës, anëtarët e OKB ia kalojnë Këshillit të Sigurimit përgjegjësinë kryesore për ruajtjen e paqes dhe të sigurisë ndërkombëtare. Madje, Karta e OKB parashikon që për sa kohë që Këshilli i Sigurimit realizon detyrat e tij në rast konflikti, Asambleja e Përgjithshme nuk duhet të japë asnjë rekomandim, përveç rastit kur ia kërkon vetë Këshilli i Sigurimit.

Të dy aktet parashikojnë strukturën organizative respektive të këtyre organizatave, por ndërsa Statuti i LK parashikonte si organe vetëm tre prej tyre: Asamblenë, Këshillin dhe Sekretariatit, duke lënë jashtë organin gjyqësor [Gjykatën e Përhershme të Drejtësisë Ndërkombëtare (GJPDN)], Karta e OKB parashikon si organe gjashtë të tilla: Asamblenë e Përgjithshme, Këshillin e Sigurimit, Këshillin Ekonomik dhe Social, Këshillin e Kujdestarisë, Sekretariatit, përfshirë edhe organin gjyqësor, Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë (GJND). Statuti i GJND, edhe pse dokument më vete, konsiderohet pjesë e Kartës së OKB, gjë që nuk ndeshet në rastin e Statutit të LK.

Si në Statutin e LK, ashtu edhe në Kartën e OKB, parashikohet që në Asamble marrin pjesë të gjitha shtetet anëtare. Ndërsa në organet ekzekutive, respektivisht Këshilli i LK dhe Këshilli i



Sigurimit (KS) i OKB, raporti midis anëtarëve të përhershëm dhe atyre të përkohshëm ndryshon: në Këshillin e LK ishte 1:1, ndërsa në Këshillin e Sigurimit të OKB është 1:2.

Statuti i LK krijonte mundësi që përveç shteteve, anëtarësia të ishte e hapur edhe për dominionet apo kolonitë, ndërsa Karta e OKB parashikon që anëtarësia është e hapur vetëm për shtetet, në mënyrë ekskluzive.

Statuti i LK e parashikonte në mënyrë të shprehur mundësinë e daljes vullnetare nga organizata, pas një njoftimi 2-vjeçar, ndërsa Karta e OKB nuk ka një parashikim të tillë.

Statuti i LK parashikonte që anëtarët e saj angazhoheshin të respektonin dhe të ruanin kundër çdo sulmi nga jashtë, tërësinë territoriale dhe pavarësinë politike të të gjithë anëtarëve të LK, duke e shndërruar *de jure* organizatën në një aleancë kolektive, ndërkohë që një gjë e tillë nuk ndeshet në Kartën e OKB.

Statuti i LK nuk e ndalonte krejtësisht përdorimin e forcës së armatosur, por parashikonte që anëtarët e LK bien dakord se në rast konflikti midis tyre, do i drejtohen arbitrazhit ose hetimit prej Këshillit, dhe në çdo rast nuk do përdornin luftën deri në tre muaj pas vendimit të arbitrazhit ose raportit të Këshillit. Ndërsa Karta e OKB e ka ndaluar përdorimin e forcës së armatosur midis shteteve, me përjashtim të rasteve të vetëmbrojtjes individuale ose kolektive, duke parashikuar që të gjithë anëtarët ndalojnë në marrëdhëniet e tyre ndërkombëtare çdo kërcënim apo përdorim force, që drejtohet kundër integritetit territorial apo pavarësisë politike të një shteti, ose që bie ndesh me qëllimet e OKB.

Pyetja III (12 pikë)

A mendoni se BE është një organizim i llojit të veçantë (sui generis)? Argumentoni përgjigjen tuaj.

Përgjigje: Bashkimi European i krijuar me Traktatin e Mاستrihtit (1993) u ngrit mbi Komunitetet Europiane të thelemuara pas Luftës së II Botërore me Traktatin e Parisit (1951) dhe atë të Romës (1957). BE është një organizim politik i llojit të veçantë i cili dallon, por ka edhe tipare të ngjashme me organizatat ndërkombëtare dhe me shtetet (qofshin këto federatat apo konfederatat). Këto tipare të veçanta të BE-së lidhen me fushën e saj të veprimit, mënyrën sesi është organizuar dhe si ndërvepron me shtetet anëtare. BE është një ndërthurje e mbikombëtarizmit dhe ndërqeveritarizmit.

Fillimisht, Komunitetet Europiane u krijuan me qëllime ekonomike-tregtare, por synimi kryesor ishte që nëpërmjet tyre të krijohet një strukturë politike mbikombëtare, e ngjashme me një



federatë apo konfederatë të shteteve europiane. Projekti politik mbikombëtar, nuk u arrit menjëherë, por erdhi në mënyrë graduale, nëpërmjet ndryshimit të traktateve.

Projekti politik me tiparet e një federate u realizua me krijimin e Bashkimit European, por pa patur domosdoshmërisht një formë të qartë. Karakteri jo-tipik (*sui generis* i BE) nuk do të thotë se ai nuk njihet juridikisht. Përkundrazi, BE është një entitet i pavarur dhe ka personalitet juridik (neni 47 TBE), të njohur dhe të pranuar në arenën ndërkombëtare.

Megjithatë, BE karakterizohet nga disa tipare të veçanta që mund të përmblihen si më poshtë:

BE vepron mbi bazën e Traktateve, të cilat miratohen me vullnetin e shteteve anëtare, sipas procedurave të tyre kushtetuese. Pjesë e traktateve të BE-së është dhe Karta e të Drejtave Themelore. BE bashkon Shtetet Anëtare, që kanë hequr dorë pjesërisht nga disa të drejta sovraane të tyre në favor të BE-së dhe i kanë dhënë Bashkimit kompetenca për të vepruar e pavarur. Fushat e veprimit të Bashkimit janë mjaft të gjera, duke përfshirë të gjitha politikat publike, që nga tregu i brendshëm, çështjet sociale, e deri tek mbrojtja e sigurisë. Në zbatim të këtyre kompetencave, BE-ja miraton legjislacion, që ka të njëjtën fuqi me ligjet e miratuara nga shtetet anëtare.

BE ka institucionet e veta: Parlamenti European zgjidhet me vota të drejtpërdrejta të shtetasve (qytetarëve) europianë, ndërkohë që institucionet e tjera janë produkt i kompromiseve politike të shteteve anëtare, apo të përfaqësimit të tyre (Komisioni dhe Këshillat). Procesi ligjvënës për një kohë të gjatë kishte tipare të ndërqeveritarizmit, ku ligjet propozoheshin nga Komisioni dhe miratoheshin nga Këshilli i Ministrave dhe Parlamenti me një rol të cinguar dhe ku kërkoheshin unanimiteti. Me reformimin e BE-së, u zgjerua roli ligjvënës i Parlamentit dhe përdoret më shumë vendimmarrja me shumicë të cilësuar, e njohur si procedura e zakonshme ligjvënëse. Sistemi gjyqësor europian është garant për zbatimin e së drejtës europiane dhe interpretimin e njëtrajtshëm (uniform) të saj.

Shtetasit e shteteve anëtare janë gjithashtu edhe shtetas/qytetarë të Bashkimit European, të cilët gëzojnë ndër të tjera, të drejtën për t'u mos diskriminuar bazuar në shtetësi, për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur, si edhe për të lëvizur dhe punuar lirisht në të gjitha shtetet anëtare të BE-së (nenet 18 dhe 20 TFBE).

BE ka aktualisht 27 shtete anëtare dhe ajo mund të zgjerohet edhe me shtete të tjera europiane që promovojnë vlerat e BE-së (neni 49 TBE).

Pyetja IV (20 pikë)

Në datat 4 dhe 5 nëntor të vitit 1979, protestues iranianë demonstuan e më pas sulmuan me armë ndërtesën e ambasadës së SHBA-së në Teheran dhe konsullatat amerikane në qytete të tjera iraniane, duke u futur forcërisht në mjediset e tyre dhe duke marrë peng personelin diplomatik dhe konsullor amerikan dhe shtetas të tjerë amerikanë, si edhe sasi të konsiderueshme dokumentacioni dhe materiale të tjera.



1. Shpjegoni qëndrimin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë në lidhje me *juridiksionin* për gjykimin e çështjes.
2. Shpjegoni qëndrimin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë në lidhje me *provat indirekte*.
3. Shpjegoni qëndrimin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë në lidhje me *përgjegjësinë e Iranit* për shkeljen e normave të së drejtës ndërkombëtare.

Përgjigje:

Në lidhje me *juridiksionin* për gjykimin e çështjes, GJND theksoi se Irani dhe SHBA janë palë në Konventën e Vjenës mbi Marrëdhëniet Diplomatike të vitit 1961, si dhe në protokollin e saj opsional, mbi zgjidhjen e detyrueshme të mosmarrëveshjeve. Gjithashtu, të dy shtetet janë palë edhe në Konventën e Vjenës mbi Marrëdhëniet Konsullore të vitit 1963, si dhe në protokollin e saj opsional, mbi zgjidhjen e detyrueshme të mosmarrëveshjeve. Përveç këtyre konventave, ata janë palë edhe në Traktatin e Miqësisë, Marrëdhënieve Ekonomike dhe të Drejtave Konsullore, të vitit 1955. Prandaj, GJND kishte juridiksion për të gjykuar çështjen.

Në lidhje me *provat indirekte*, GJND iu referua vendimit të saj në çështjen e Incidentit të Kanalit të Korfuzit, ku kishte theksuar mundësinë e palës së dëmtuar për paraqitjen provave indirekte, duke mbajtur parasysh vështirësitë që kishte objektivisht kjo palë për të paraqitur prova të drejtpërdrejta. Shtetit të dëmtuar duhet t'i tolerohet paraqitja e fakteve dhe rrethanave jo të drejtpërdrejta, pasi provat indirekte pranohen në të gjitha sistemet e së drejtës dhe përdorimi i tyre njihet edhe në vendimarrjen ndërkombëtare. Atyre duhet t'u jepet një peshë e veçantë, nëse bazohen në një seri faktesh që lidhen së bashku, të cilat të shpjen logjikshëm në një konkluzion të vetëm. Meqë ngjarjet ishin zhvilluar në territorin e shtetit shkaktar të dëmit, Iranit, e duke mbajtur parasysh refuzimin e tij për bashkëpunim, si dhe faktin që Irani vazhdonte ende të mbante peng diplomatët amerikanë, shteti i dëmtuar, SHBA, ndodhej në pamundësi objektive për të paraqitur prova të drejtpërdrejta, prandaj mund t'i lejohej paraqitja e provave indirekte.

Në lidhje me *përgjegjësinë e Iranit* për shkeljen e normave të së drejtës ndërkombëtare, GJND vendosi që pengmarrja e diplomatëve amerikanë nga protestuesit mund t'i atribuohet Iranit vetëm nëse protestuesit kishin vepruar në emër të shtetit.

Në rastin konkret, ndonëse protestuesit nuk kishin vepruar direkt në emër të shtetit, veprimet e tyre mund t'i atribuoheshin shtetit Iranian, për shkak të qëndrimit të autoriteteve shtetërore, të cilat nuk kishin përmbushur detyrimin për marrjen e masave të domosdoshme për mbrojtjen e selisë diplomatike, të personelit të saj dhe të arkivit. Irani nuk kishte bërë asgjë për të penguar sulmin e armatosur ndaj tyre. Ky qëndrim binte haptazi të kundërshtim me vetë veprimet e mëparshme të Iranit, kur kishte ditur të mbronte jo shumë kohë më parë përfaqësitë diplomatike të disa shteteve, përfshirë këtu edhe ambasadën amerikane. Prandaj, Irani kishte shkelur në këtë rast detyrimet ndërkombëtare për mbrojtjen e selisë së misionit diplomatik e konsullor, të personelit diplomatik dhe konsullor, si edhe të arkivit diplomatik e konsullor, përfshirë paprekshmërinë e valixhes diplomatike dhe të drejtën e komunikimit me shtetasit e shtetit dërgues. Përveç këtyre detyrimeve, Irani nuk kishte përmbushur as detyrimet për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut, duke lejuar mbajtjen peng të tyre dhe vendosjen në kushte tepër të vështira, çka binte ndesh me Kartën e OKB dhe me parimet e Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut.

